



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN280320230010

Tiranë, më: 26.04.2023

Komisioni 46

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person Juridik:** “**BUILDING CONSTRUCTION**”Sh.p.k

**Nr. NIPT-i:** L11401034P

**Adresa e selisë:** Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Tiranë.

**Personi përgjegjës:** Imer Memetaj

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim guri gëlqeror me karrierë.**”

Aplikimi është bërë referuar ligjitNr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zone minerare 154/9, objekti Radovicka, Përmet, qarku Gjirokastrë

**Të dhëna teknike:**

Sipërfaqe 0.989 km<sup>2</sup>

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

## **Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:* • Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis, gjatë fazës së punimeve, rekomandohet:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i punimeve dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, shprehemi si më poshtë vijon:

• Ligji i cituar në raport nr.8897/2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” është shfuqizuar dhe aktualisht është në fuqi ligji nr. 162/2014 i ndryshuar “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i cili shoqërohet me disa akte nënligjore të dala në zbatim të tij.

• Sugjerojmë që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve.

Sa i takon sektorit të biodiversitetit, sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet t’i përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitim e zonës me mbjellje pemësh.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. Të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura:* Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkohet zhvillohet aktiviteti “Shfrytëzimi i karrierës së mineralit gur gëlqeror”, Zona Minerare 154/9, Objekti “Radovicka”, Përmet, Qarku Gjirokastrë, me zhvillues dhe aplikues BULIDING CONSTRUCTION me nr. Aplikimi AN280320230010, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit: Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve

për dhënien e mendimit për VNM të Thelluar u mbështet në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/ Vlorë/ Gjirokastrë ngriti grupin e punës më datë 11.04.2023 për subjektin “Building Construction” Sh.p.k me aktivitet “Shfrytëzim i karrierës minerare gur gëlqeror” dhe vendodhje zona minerare Nr.154/9, objekti “Radovicka”, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë. Shoqëria “Building Construction” sh.p.k kërkon të fillojë aktivitetin minerar në shfrytëzimin e mineralit gurë gëlqeror në zonën e minerare nr.154/9, objekti “Radovicka”, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë. Zona e parashikuar për shfrytëzim ndodhet në distancë rreth nga 1.5 - 2 km në vijë ajrore nga fshatrat Koplare dhe Vercisht – Gostromicka. Në distancë ajrore rreth 300 – 350 m nga sipërfaqja e zonës së projektit ndodhet degë furnizuese e lumit Osum. Në afërsi të zonës së prashikuar për shfrytëzim nuk vihen reobjekte të rëndësishme kulturi, me karakter historik, fetar apo kulturor etj. Projekti I propozuar ndodhet në distancë rreth 6.5 – 7 km në vijë ajrore nga Zona e Mbrojtur e Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës – Dangëlli. Bimësia në zonën e projektit është kryesisht e zhveshur, bimësi e egër me shkruie të imta me karakter mesdhetar, krekëza, dushqe, etj, bimësi e vetë zhvilluar. Për zhvillimin e aktivitetit është e nevojshme hapja e rrugëve të reja në brendësi të sipërfaqes si dhe rehabilitimi e rrugëve ekzisuese për në vendndodhje.

*Sugjerime:*

- Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujqor dhe atë tokësor.
- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedisin tokë do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.
- Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Gjatë transportit të përdoren mushamatë e kamionave për të shmangur përhapjen e dherave e të materialeve inerteve në rrugët lidhëse të zonës.
- Të merren masa për të zvogëluar ose zbutur efektet e zhurmës dhe dridhjeve aty ku ato janë praktike dhe me kosto efektive.
- Të merren masat për lagjen e rrugëve të aksesit në kantier të cilat do të përdoren nga mjetet e tonazhit të lartë duke ulur mundësinë e përhapjes së grimcave të ngurta në mjedis.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të bëhet sistemimi, rehabilitimi i shesheve dhe të krijohen sipërfaqe të gjelbërta rreth objektit, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
- Në rast se do të kemi dëmtim të habitateve të merren masa për rehabilitimin e tij ose zëvendësimin me habitat të ri.
- Të merren masa për zbutjen e ndikimit në peizazh duke ruajtur me sa është e mundur natyralitetin e zonës.
- Të tregohet kujdes në largimin e zonës vegjetale dhe mos të përzihet me mbetje të tjera.
- Të tregohet kujdes gjatë punimeve në mënyrë që ato të mos ndikojnë në zonat e mbrojtura. Të rrethohet perimetri i zonës së shfrytëzimit me pemë.
- Të kryhet rehabilitimi pas cdo shkallë të shfrytëzuar.
- Të largohen të gjitha mbetjet të cilat nuk do të ripërdoren në vendin e depozitimit përfundimtar bazuar në Ligjin nr 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Të ndiqet procedura e heqjes nga fondi pyjor/kullësor bazuar ne legjislacionin përkatës.
- Gjatë dëgjësës me publikun subjekti ka partneritet të mirë.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* U krye ne daten 24.03.2023, ora 12:00. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- **Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.**
  - **Shkresa nga MIE nr.8425/1 datë 30.11.2022 “Mbi aplikimin për leje minerare shfrytëzimi me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore për zonën Nr.154/9.**
- 4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**
- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT/Bashkia/Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.3** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.4** Aktiviteti të kryhet brenda sipërfaqjes së zonës minerare të miratuar si dhe në bazë të vlefshmërisë së Lejes së Shfrytëzimit.
- 4.5** Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Te kete ne vemendje te veacnte referencat kadastrale qe preken nga ushtrimi i aktivitetit.

## **Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.6** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7** Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9** Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislationit në fuqi.
- 4.10** Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.

- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të bëhet rehabilitim i zonës me mbjellje pemësh, dhe me masa konkrete kundër erozionit dhe ndikimeve në tokë.
- 4.20 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.21 Subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet t’i përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve:  
-Ligjin nr. 9587, date 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar;  
-Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për Mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar
- 4.22 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.
- 4.23 Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve/mjedisit në fuqi dhe për zbatimin e tyre.
- 4.24 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.25 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.26 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.27 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.28 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

## 5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### - Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vleresimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi:*

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	26.10.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	26.10.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	26.10.2023	Çdo 6 muaj

**- Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
07.04.2023	20-25 µg/m <sup>3</sup>	26.10.2023	Çdo 6 muaj
07.04.2023	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	26.10.2023	Çdo 6 muaj

**- Cilësia e ujrave**

*Parametrat që duhet të monitorohen*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	26.10.2023	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.



**- Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**


**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

*Konceptoi:*

*Pranoi:*

**Aneksi 1. Harta Topografike me koordinatat.**



Kordinatat e pikave që kufizojnë zonën e shfrytëzimit		
Nr.	Y	X
1.	44 52 547	44 77 400
2.	44 52 500	44 77 842
3.	44 52 680	44 78 350
4.	44 53 540	44 78 560
5.	44 53 710	44 77 665
<b>Sipërfaqja e zonës së kërkuar: S = 0.989 km<sup>2</sup></b>		